KËSHILLI I NDERIT PRANË SHOQATËS SË GAZETARËVE TË MAQEDONISË, SHGM, në seancën e mbajtur më 20.04.2023, duke vepruar pas parashtresës së dorëzuar nga "Trupi Koordinues për ndërmarrjen e veprimtarive për realizimin e të drejtave nga aksionet prioritare të Stopanska Banka SHA Shkup" kundër disa mediave-portaleve, e solli këtë VENDIM REFUZOHET PARASHTRESA PËR MOSPUBLIKIM TË PALËS SË DYTË, TË DORËZUAR NDAJ DHJETËRA MEDIAVE

ARSYETIM

Trupi Koordinues për ndërmarrjen e veprimtarive për realizimin e të drejtave nga aksionet prioritare të Stopanska Banka SHA Shkup, deri tek Këshilli i Nderit pranë SHGM-së dorëzoi më shumë parashtresa kundër më shumë portaleve-mediave, me pohim se nuk e kanë publikuar reagimin e tyre për një informacion – analizë, të publikuar në Bursën Maqedonase, e që ka të bëjë me aksione të Stopanska Bankës SHA – Shkup, që ata e kanë dërguar deri tek mediat e përmendura, shumica e të cilëve raportojnë për biznes dhe ekonomi.

Sipas nenit 3 nga Kodeksi i Gazetarëve të Maqedonisë, "gazetari do të insistojë që të sigurohet publikimi i korrigjimit, demantit dhe përgjigjes, në rastet kur do të konstatohet pavërtetësia e informatës"

Pas shqyrtimit të detajuar të parashtresës, Këshilli i Nderit pranë SHGM-së konstatoi se parashtruesi reagon për Analizën e publikuar nga Bursa Maqedonase e jo për informacionin që është krijuar apo produktin autorial të mediave që i thekson, prandaj parashtruesi, në rast se vlerëson se informacioni nuk është i saktë, duhet të reagojë deri tek krijuesi i informacionit dhe prej tij të kërkojë korrigjim.

Nga përmbajtja e mëtejme e parashtresës rezulton se parashtruesi ka çështje të pazgjidhura ligjore me Bordin Drejtues dhe Mbikqyrës të Stopanska Bankës SHA – Shkup, që janë çështje që nuk duhet ti zgjidhin nëpërmjet mediave por me veprime juridike para Gjykatës kompetente,

Komisionit për Letra me Vlerë apo Bursa Maqedonase. Pohimet e parashtruesit se “mediat janë paguar me reklama nga ana e Stopanska Bankës SHA –

Shkup , që të mos i publikojnë njoftimet e tyre, Këshilli i Nderit i vlerësoi si pa bazë dhe të pa

mbështetura me prova.

Për këto arsyem Këshilli i Nderit vendosi që ta refuzojë Parashtresën pasi që nuk ka vërejtur

shkelje të Kodeksit të Gazetarëve të Maqedonisë.

Vendosur në Shkup, më 20.4.2023

KËSHILLI I NDERIT PRANË SHGMS-SË

Kryetar i Këshillit

Sashe Dimovski